



**REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
KËSHILLI BASHKIAK TIRANË**

**V E N D I M**

Nr.29.dt.10.03.2000

**PER  
MIRATIMIN E SHITESES SE LIMITIT TE TE ARDHURAVE PER INVESTIMET E  
VITIT 2000 DHE DETAJIMI I FONDIT PREJ 25 MILION LEKE, BLERJE  
MAKINERI E PAJISJE**

Këshilli i Bashkisë i Tiranës, i mbledhur sot më dt.10.03.2000 pasi mori në shqyrtim kërkesën e Drejtorisë së Përgjithshme të Punëve Publike dhe Shërbimeve “Për detajimin e fondit prej 25 milion lekë sipas vendimit Nr.13 dt.03.03.2000, blerje makineri e pajisje për Nd. Ujësjiellës Kanalizime dhe Nd. Mir`mbajtje Rugëve”, si dhe kërkesës së Drejtorisë së Financës “Për rritje të limitit nga të ardhurat për investimet e vitit 2000”, mbështetur në ligjin Nr.7776 dt.22.12.1993 Neni 5 “Për buxhetin lokal”, ligjit Nr.7572 dt.10.06.1992 Neni 14 “Për organizimin e funksionimin e pushtetit lokal në Republikën e Shqipërisë” dhe akteve të tjera nënligjore në zbatim të tyre

**V E N D O S I**

1. Të miratoi shtesën e limitit të përdorimit të të ardhurave për investimet e vitit 2000 në masën 28.338.262 lekë sipas pasqyrës bashkëlidhur.
2. Të miratoi detajimin e fondit të investimeve prej 25 milion lekë për makineri dhe pajisje si më poshtë
  - 1.Mjete transporti 1-1.5 ton      copë 10      4.900.000 lekë

2.Motopompë Q-25 l/sek+aksesorë	copë 1	1.300.000 lekë
3.Autovetura të përdorura	copë 2	1.300.000 lekë
4.Motoçikleta	copë 4	1.200.000 lekë
5.Kompjuter profesional + aksesor	copë 2	440.000 lekë
6.Pajisje zyrës teknike		1.000.000 lekë
7.Kamjon riportabël 10-15 ton	copë 1	2.200.000 lekë
8.Instalim rrjeti kompjuterik në Aparatin e Bashkisë		1.050.000 lekë
<b>SHUMA</b>		<b>=13.390.000 LEKE</b>

3. Për zbatimin e këtij vendimi ngarkohet Drejtoria e Përgjithshme e Punëve Publike dhe Shërbimeve, Drejtoria e Financës, Nd. Ujësjetës Kanalizimeve dhe Nd. Rrugëve
4. Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETARI**

**ORHAN SAKIQI**







